

Procedurat e Shfuqizimit të Certifikatës AKSHI

Versioni 1.0

Prill 2014

INDEKS

1. Hyrje	3
2. Revokimi i Certifikatës	3
2.1 Revokimi.....	3
2.2 Listat e Certifikatave të Revokuara (CRL)	4
2.3 Procedurat e shfuqizimit të certifikatës.....	4
2.4 Procedurat e shfuqizimit të certifikatës kur kërkesa vjen nga vetë përdoruesi	4

1. Hyrje

Infrastruktura me çelës publik e AKSHI-t (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) ka për qëllim të ofrojë zgjidhje (produkte dhe shërbime) për aplikime të sigurta kompjuterike dhe të rrjetit. Infrastruktura me çelës publik (PKI) përbëhet nga produkte dhe shërbime që ofrojnë dhe menaxhojnë certifikata dixhitale X. 509 për enkriptimin e çelësit publik.

Ky dokument paraqet Procedurat e Dorëzimit të Certifikatës të cilat aplikohen në Infrastrukturën me Çelës Publik të AKSHI-t.

Procese të detajuara dhe teknike janë të specifikuara në Deklaratën e Politikave të Certifikimit dhe Politikat e Certifikimit.

2. Revokimi i Certifikatës

2.1 Revokimi

2.1.1 Certifikata revokohet kur:

- Informacioni brenda certifikatës ka ndryshuar (personi ka lënë institucionin, personi ka vdekur, është vënë nën ndalim, është shkëputur për periudha të gjata nga marrëdhëniet e punës, etj);
- Privilegjet e dhëna për Subjektin nëpërmjet certifikatës janë anuluar apo kufizuar;
- Është vërtetuar se Subjekti ka shkelur detyrimet e marrëveshjes me RA;
- Çelësi privat apo të dhënat e aktivizimit janë kompromentuar (humbur ose vjedhur);
- Subjekti ose në një tjetër njësi e autorizuar kërkon revokimin e certifikatës.

Certifikatat e revokuara janë të vendosura në CRL deri sa të përfundojnë.

2.2.2 Procedura e kërkesës për revokim përfshin metoda elektronike apo në letër. RA duhet të vërtetojë kërkesën në mënyrë për të parandaluar sulmet dashakeqe. Nëse është kështu, RA do të revokojë certifikatën duke vendosur numrin e saj serial në CRL. RA do të informojë mbajtësin e certifikatës për revokimin.

2.2 Listat e Certifikatave të Revokuara (CRL)

CA nxjerr dhe publikon CRL periodikisht. Publikimi do të bëhet në dosje, në intervale të caktuara kohore, edhe në qoftë se nuk ka përditësime me versionet e mëparshme. CA duhet të publikojë mënyrat në të cilat mund të merret informacion mbi CRL dhe të shpjegojë pasojat e përdorimit të certifikatave tashme të publikuara në CRL. Është përgjegjësi e palëve të treta që përdorin certifikata për të marrë listat e përditësuara të CRL në kohën e duhur.

Frekuencat e mëposhtme për publikimin e CRL janë të rekomanduara:

- Class 1 - CA do të publikojë CRL të paktën një herë në shtatë ditë dhe një certifikatë që njoftohet si e kompromentuar do të shfaqet në CRL brenda 48 orëve.
- Class 2 - CA do të publikojë CRL të paktën një herë në dy ditë dhe një certifikatë që njoftohet si e kompromentuar do të shfaqet në CRL brenda 24 orëve.
- Class 3 - CA do të publikojë CRL të paktën një herë në dy ditë dhe një certifikatë që njoftohet si e kompromentuar do të shfaqet në CRL brenda 48 orëve.
- Class 4 - CA do të publikojë CRL të paktën një herë në dy ditë dhe një certifikatë që njoftohet si e kompromentuar do të shfaqet në CRL brenda 24 orëve.

2.3 Procedurat e shfuqizimit të certifikatës

Në rast kur AKSHI merr një informacion me anë të një shkrese zyrtare apo e-mail zyrtar nga personi i kontaktit të institucionit i cili përdor certifikatën atëherë:

- Serial vendoset në listën e CRL,
- RA njofton personin, i cili mban certifikatën me anë të e-mailit për vënie në dijeni të revokimit të certifikatës. Njoftohet personi i kontaktit në institucionin përgjegjës për vënie në dijeni të revokimit të certifikatës.
- Dërgohet shkresë zyrtare në institucionin përgjegjës për vënie në dijeni të revokimit të certifikatës

2.4 Procedurat e shfuqizimit të certifikatës kur kërkesa vjen nga vetë përdoruesi

Në rast kur AKSHI merr një informacion me anë të e-mailit apo telefonatës nga vetë përdoruesi për shfuqizimin e certifikatës atëherë:

- a) Sigurohet/Verifikohet që personi është ai i cili pretendon duke kërkuar numrin personal të personit, institucionin ku punon dhe pozicionin e punës.
- b) Nëse vërtetohet identiteti i personit atëherë procedohet duke:
 - Serial i certifikatës vendoset ne listën e CRL,
 - RA njofton personin, i cili mban certifikatën me anë të e-mailit për vënie në dijeni të revokimit të certifikatës. Njoftohet personi i kontaktit në institucionin përgjegjës për vënie në dijeni të revokimit të certifikatës.
 - Dërgohet shkresë zyrtare në institucionin përgjegjës për vënie në dijeni të revokimit të certifikatës.